

VENDIM
Nr. 660, datë 8.10.2014

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 693, DATË 16.8.2013,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E AUTORIZIMIT TË
NDËRTIMIT TË CENTRALIT ELEKTRIK ME ERË (PARQE EOLIKE) DHËNË
SHOQËRISË “POWER WIND ENERGY”, SHPK”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 34/1, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 693, datë 16.8.2013, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Kudo në vendim, emërtimi “Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës” zëvendësohet me “Ministria e Energjisë dhe Industrisë”.

b) Në tekstin “Autorizim”, bashkëlidhur vendimit, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

i. Në pikën 4, fjalët “... brenda datës 31.12.2014 ...” zëvendësohen me “... brenda datës 31.12.2022, në përputhje me afatet e zërave të punës, sipas grafikut të zbatimit të punimeve, bashkëlidhur këtij autorizimi ...”.

ii. Pas shkronjës “e”, të pikës 8, shtohet shkronja “ë”, me këtë përmbajtje:

“ë) “Power Wind Energy”, sh.p.k.”, nuk respekton afatet dhe kushtet e përcaktuara në grafikun e punimeve.”.

2. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

AKTIVITETI	PERIUDHA		
NIVELI 1	DATA E FILLIMIT	Kohe zgjatja (dd)	DATA e MBARIMIT
Përgatitja e kantierit Libohove	9/1/2016	50	10/21/2016
Rrugët e lidhjes	10/22/2016	352	10/9/2017
Themelet	4/11/2017	445	6/30/2018
Kanali i kavos midis kullave eolike	3/1/2018	443	5/18/2019
Linja e lidhjes nga parku eolik tek nënstacioni	5/15/2019	240	1/10/2020
Kullat dhe aerogjeneratorët	1/10/2020	963	8/30/2022
Punime parapërgatitore dhe vepra aksesore linja e interkoneksionit 500 MW Shqipëri-Greqi	2/1/2019	434	4/10/2020
Linja e interkoneksionit nga 500 MW Shqipëri-Greqi	4/10/2020	933	10/30/2022
Vepra të ndryshme plotësuese	3/1/2018	1720	11/15/2022
Kontrollet e sigurisë së punimeve	9/1/2016	2281	11/30/2022
Kolaudimi i brendshëm	10/9/2017	1878	11/30/2022
Kolaudimi nga autoritetet shqiptare parku eolik me linjen e interkoneksionit 500 MW AL-GR	11/30/2022	31	12/31/2022

